

**LIGJI  
QË NDRYSHON LIGJIN PËR LËNDËT PLASËSE**

**Neni 1**

Në ligjin për lëndët plasëse (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, numër 49/08), në nenin 3 paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:

“Lëndë plasëse për qëllime tregtare janë lëndët plasëse që përdoren për thyerjen, copëtimin dhe thërrmimin e lëndëve minerare dhe lëndëve të tjera, për shkatërrimin e objekteve të ndërtimit dhe të objekteve të tjera, në kërkimin gjeofizik të terrenit, si dhe formësimi i objekteve dhe materialeve nëpërmjet energjisë së çliruar me reaksion kimik të shpërbërjes me shpërthim.”

**Neni 2**

Pas nenit 4 shtohet nen i ri, si më poshtë:

**“Përdorimi i gjuhës me ndjeshmëri gjinore**

**Neni 4a**

Termtat të cilat nëpërmjet këtij ligji përdoren për persona fizik në gjininë mashkullore, nënkuptohen të njëjta në gjininë femërore.

**Neni 3**

Në nenin 5 paragrafi 1 pika 1 fjala “(çmontim)” fshihet. Pas pikës 1 shtohet pikë e re si më poshtë:

“1a) **çmontimi** përfshin veprimet e çmontimit të llojeve të caktuara të municionit (plumbave, bombave, minave) në elemente përbërës dhe heqjen e barutit, të lëndës plasëse dhe të materialeve të tjera

nga elementet dhe pjesët e municioneve;”.

Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11) **arkë portative** është objekt i posaçëm i vendosur brenda ndërtesës tregtare për armët dhe municionet ose objektit të shitjeve të pajisjeve piroteknike dhe shërben për magazinimin e municionit, barutit të gjuetisë, fitilave për municion gjuetie dhe pajisjeve piroteknike, fitilave me djegie të ngadaltë, me kusht që sasia e përgjithshme e barutit duke përfshirë edhe barutin edhe municionin, nuk mund të jetë më e lartë se 20 kg barut bruto ose 150 kg të pajisjeve piroteknike;”.

Pika 12 ndryshohet dhe bëhet:

“12) **kontejner** është një arkë e lëvizshme ose e transportueshme e krijuar për magazinimin e lëndëve plasëse;”.

Pas pikës 12 shtohet pikë e re, e cila bëhet:

“13) **numri sipas OKB-së (UN)** është numër identifikues katërshifror i lëndës plasëse i përcaktuar në rregulloren që është dokument shoqëruar i botimit të katërmbëdhjetë të rishikuar të Rekomandimeve për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, të botuar nga Kombet e Bashkuara (ST/SG/AC.10/1/Rev.14).”

**Neni 4**

Në nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 7 pas fjalës “riciklim” në raste të ndryshme vendoset presje, ndërsa fjala “(çmontim)” në rastin përkatës, zëvendësohet me fjalën “çaktivizim”.

**Neni 5**

Në nenin 11, paragrafi 2 fshihet.

**Neni 6**

Në nenin 12 paragrafi 6 dhe neni 15 paragrafi 2 fjalët: “zhvillim ekonomik” zëvendësohen me fjalën “ekonomi”.

**Neni 7**

Në nenin 22 paragrafi 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Prodhimi i lëndëve plasëse mund të kryhet nga shoqëri tregtare të cilat janë regjistruar për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe të cilat kanë leje për prodhimin e lëndëve plasëse (në vijim të tekstit referuar si prodhuesi).”

#### **Neni 8**

Në nenin 23 paragrafi 2 fjalët “diplomë universitare” zëvendësohen dhe bëhen “niveli i shtatë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit, nëniveli një (VII-1).

#### **Neni 9**

Në nenin 24 paragrafi 1, nënparagrafi 1, neni 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1 dhe neni 48 paragrafi 1, nënparagrafi 1, fjalët “Regjistri qendror i gjykatës tregtare” zëvendësohen me fjalët “Regjistri qendror i subjekteve tregtare”.

#### **Neni 10**

Neni 25 ndryshohet dhe bëhet:

#### **“Riciklimi, çmontimi dhe neutralizimi**

#### **Neni 25**

Prodhuesi mund të kryejë riciklimin, çmontimin dhe neutralizimin e lëndëve plasëse.”

#### **Neni 11**

Neni 27 ndryshohet dhe bëhet:

“Prodhuesi ruan lëndë plasëse në ambiente magazinimi”.

#### **Neni 12**

Pas nenit 30 shtohet një paragrafi i ri me tetë pika, të cilët bëhen:

#### **“30a. Prodhimi në vendin e përdorimit**

#### **Leja për prodhimin në vendin e përdorimit**

#### **Neni 30a**

Prodhimi i lëndëve plasëse në vendin e përdorimit mund të kryhet nga shoqëria tregtare e cila është e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë dhe ka leje për prodhimin e lëndëve plasëse në vendin e përdorimit.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga Ministria.

Leja e përmendur në paragrafit 1 të këtij neni lëshohet për një periudhë kohore dy vjeçare.

#### **Kushtet për prodhimin në vendin e përdorimit**

#### **Neni 30 b**

Shoqëria tregtare e përmendur në nenit 30a të këtij ligji duhet të ketë:

- Personin përgjegjës
- Personin i cili do të administrojë lëndët plasëse gjatë prodhimit;
- Pajisjet e specializuara për prodhimin e menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë të lëndëve plasëse në vendin e përdorimit;
- dëshminë e prodhuesit që lënda e parë për prodhim nuk është plasëse, në përputhje me numrin sipas OKB-së.

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 pika 1 të këtij neni duhet të ketë nivelin e shtatë të kuadrit të brendshëm të kualifikimit, nëniveli një (VII-1) dhe të plotësojë kushtet për administrim sipas nenit 19 të këtij ligji.

Personat e përmendur në paragrafit 1 pika 2 të këtij neni duhet të kenë të paktën nivelin e tretë të kuadrit të brendshëm të kualifikimit (III) dhe të plotësojnë kushtet për administrim sipas nenit 19 të këtij ligji.

#### **Kërkesa për leje për prodhim në vendin e përdorimit**

#### **Neni 30c**

Shoqëria tregtare e përmendur në nenit 30a të këtij ligji, me kërkesë për leje për prodhimin e lëndëve plasëse në vendin e përdorimit, krahas provave për plotësimin e kushteve nga nenet 6 dhe 7 dhe neni 24 paragrafi 1 pika 1,2,3,7, dhe 8 të këtij ligji, bashkëngjit:

- të dhënat për vendin e përdorimit në të cilin do të kryhet prodhimi;
- Të dhënat për kuadrin kohor në të cilën do të kryhet prodhimi;
- Arsyetimin për prodhim në vendin e përdorimit.

### **Lëndët plasëse që prodhohen në vendin e përdorimit**

#### **Neni 30d**

Shoqëria tregtare e përmendur në nenin 30a të këtij ligji, në vendin e prodhimit mund të prodhojë lëndët plasëse të mëposhtme:

- Nitrat amoni i përzier në vend dhe drejtpërdrejt me vajra me bazë naftë, me vajra të rafinuar ose vajra sintetikë;
- Nitrat amoni i përzier në vend dhe drejtpërdrejt me lëndë të tjera me qëllim prodhimi të lëndëve plasëse dhe që nuk janë të ndjeshme ndaj prajmerit detonues;
- Lëndë plasëse të cilat përftohen me përzierjen në vend dhe të drejtpërdrejtë të lëndëve me bazë nitrat amoni dhe lëndë të tjera të cilat në vetvete nuk janë plasëse.

### **Ndalimi i paketimit dhe magazinimit**

#### **Neni 30e**

Shoqëria tregtare e përmendur në nenit 30a të këtij ligji është e detyruar që lëndën e prodhuar plasëse në vendin e përdorimit të përdorë menjëherë dhe drejtpërdrejt duke mbushur vrimat e parapërgatitura të minave në vendin e përdorimit.

Shoqëria tregtare e përmendur në paragrafin 1 i këtij neni nuk mund të paketojë dhe magazinojë lëndën plasëse të prodhuar.

### **Vendi i përdorimit**

#### **Neni 30f**

Vendi i prodhimit në të cilin kryhet prodhimi i lëndëve plasëse duhet të jetë brenda kantierit të ndërtimit, respektivisht të hapësirës kërkimore – shfrytëzuese dhe në një distancë sigurie nga vendet e banimit, rrugët publike, instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, në përputhje me dokumentacionin e projektit.

### **Ruajtja e përhershme fizike**

#### **Neni 30g**

Vendi i përdorimit në të cilin kryhet prodhimi i lëndëve plasëse duhet të jetë në ruajtje fizike të përhershme, në përputhje me rregulloret me të cilat rregullohet ruajtja e pronës dhe e njerëzve.

### **Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes**

#### **Neni 30h**

Leja për prodhimin e lëndëve plasëse në vendin e përdorimit ndërpret vlefshmërinë me kërkesë të shoqërisë tregtare të përmendur në nenin 30a të këtij ligji, në qoftë se shoqëria tregtare nuk i përmbush më kushtet sipas nenit 30b të këtij ligji ose me përfundimin e kohës për të cilën është lëshuar leja.

Shoqëria tregtare e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është e detyruar që t'i dërgojë ministrisë evidencat që ka mbajtur në përputhje me këtë ligj, brenda afatit prej tetë ditësh nga data nxjerrjes së vendimit për hyrjen në fuqi të ndërprerjes së vlefshmërisë së lejes për prodhimin e lëndëve plasëse në vendin e përdorimit.”

### **Neni 13**

Në nenin 31 paragrafi 2 ndryshohet dhe bëhet:

“Në trafikimin e lëndëve plasëse në përmbajtjen e këtij ligji nuk konsiderohet shitja me pakicë e pajisjeve piroteknike të kategorisë I, municionit, barutit dhe kapsollave detonatore për municionin në objektet shitëse të shoqërive tregtare, të personave të tjerë juridikë dhe të sipërmarrësve të cilëve u është dhënë leja për tregti, në përputhje me rregulloret të veçanta.”

#### **Neni 14**

Në nenin 33 paragrafi 2 fjalët “diplomë universitare për një degës të caktuar” zëvendësohen me fjalët “niveli i shtatë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit, nëniveli një (VII - 1) në industrinë e minerave dhe nga fakultete të tjera teknike”.

#### **Neni 15**

Në nenin 37 paragrafi 1, pas fjalëve: “një person fizik”, vendoset pikë, ndërsa fjalët: “që zotëron lejen për blerjen e lëndëve plasëse”, fshihen.

#### **Neni 16**

Në nenin 38 paragrafi 5 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi fizik i cili blen pajisje piroteknike të kategorisë I dhe II për përdorim personal nuk duhet të ketë leje për blerje”.

#### **Neni 17**

Neni 42 ndryshohet dhe bëhet:

“Shoqëria tregtare, persona të tjerë juridikë dhe sipërmarrësi që kryen veprimtari minerare, është i detyruar që lëndët e papërdorura plasëse t'i vendosë në kontejner për magazinim.

Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, nëse janë të asgjësueshme, lëndët plasëse të papërdorura duhet të asgjësohen në kantier.

Sasia maksimale e lëndëve plasëse e cila mund të magazinohet në kontejnerët e magazinimit është 1000 kg i lëndëve plasëse tregtare dhe 2000 copë të mjeteve ndezëse.”

#### **Neni 18**

Në nenin 43 paragrafi 1 fjalët “dhe përdorimin”, fshihen.

#### **Neni 19**

Neni 45 ndryshohet dhe bëhet:

“Pajisjet piroteknike ndahen në:

1) Pajisje piroteknike për fishekzjarrët, pajisje piroteknike të synuara për argëtim, dhe konkretisht:

- Pajisjet piroteknike të kategorisë I, të cilat përbëjnë pak ose aspak rrezik, krijojnë zhurmë të papërfillshme dhe që janë të destinuara për përdorim të jashtëm, përfshirë pajisjet piroteknike të synuara për ambiente të brendshme,

- Pajisjet piroteknike të kategorisë II, të cilat përbëjnë rrezik të vogël, krijojnë pak zhurmë dhe që janë synuar për përdorim të jashtëm,

- Pajisjet piroteknike të kategorisë III, të cilat përbëjnë rrezik mesatar dhe janë synuar për përdorim të jashtëm në ambiente të hapura të mëdha, niveli i zhurmës së të cilave nuk është i dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe që mund ta përdoren vetëm nga personat e kualifikuar të përmendur në nenin 19 të këtij ligji,

- Pajisjet piroteknike të kategorisë IV të cilat përbëjnë rrezik të madh, niveli i zhurmës së të cilave nuk është i dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe të cilat mund të përdoren vetëm nga personat e kualifikuar të përmendur në nenin 19 të këtij ligji

2) pajisjet piroteknike për përdorim në teatër, të cilat përdoren në skena të brendshme dhe të jashtme, përfshirë produksione kinematografike dhe televizive dhe konkretisht:

- Pajisjet piroteknike të kategorisë T1, të cilat përbëjnë rrezik të vogël,

- Pajisjet piroteknike të kategorisë T2, të cilat mund të përdoren vetëm nga persona të kualifikuar të përmendur në nenin 19 i këtij ligji;

3) mjete të tjera piroteknike, dhe konkretisht:

- Pajisje piroteknike të kategorisë P1, të cilat përbëjnë rrezik të vogël, në të cilat bëjnë pjesë edhe pajisjet piroteknike që janë pjesë përbërëse e pajisjeve të anijeve për nevoja të shpëtimit në det,

- Pajisjet piroteknike të kategorisë P2, të cilat përbëjnë rrezik të madh, ku përfshihen edhe raketat kundërbreshërit, të cilat mund t'i përdorin vetëm personat e kualifikuar të përmendur në nenin 19 të këtij ligji.

Kategorizimi i pajisjeve piroteknike, sipas mënyrës së përdorimit dhe qëllimit, shkallës së rrezikshmërisë dhe ndotjes nga zhurma, kryhet nga prodhuesi.

Kushtet e sigurisë që duhet të plotësojnë pajisjet piroteknike sipas karakteristikave dhe etiketimi i tyre kryhet nga ministria.”

#### **Neni 20**

Pas nenit 45, shtohen katër nene të rinj, të cilët bëhen:

#### **“Kushtet për shitjen e mjeteve piroteknike**

##### **Neni 45a**

Shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi të përmendur në nenin 32 të këtij ligji, për shitjen e pajisjeve piroteknike të kategorisë II dhe P1, krahas kushteve të parashikuara në seksionin 33 të këtij ligji, duhet të kenë:

- ambient për shitje dhe
- të paktën një punonjës të kualifikuar profesionalisht sipas nenit 19 të këtij ligji.

#### **Ambienti për shitjen e pajisjeve piroteknike**

##### **Neni 45b**

Ambientet për shitje të përmendura në nenin 45a të këtij neni, krahas kushteve minimale teknike dhe kushteve të tjera të përcaktuara me rregulloret që rregullojnë tregtinë e brendshme, duhet të plotësojnë edhe kushte të tjera të posaçme për sigurinë.

Kushtet e posaçme të sigurisë të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni parashikohen nga ministria, me miratim të organit të administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e tregtisë së brendshme.

#### **Shitja e pajisjeve piroteknike**

##### **Neni 45c**

Pajisjet piroteknike të kategorisë I mund të jenë në shitje gjatë vitit dhe mund t’u shiten vetëm personave me moshë mbi 16 vjeç dhe sasia e lejueshme bruto e pajisjeve piroteknike të kategorisë I që mund të mbahet në objektet e shitjes, që përmenden në nenin 31 paragrafi 2 i këtij neni, është deri 100 kg.

Pajisjet piroteknike të kategorisë P1 mund të jenë në shitje gjatë vitit dhe mund t’u shiten vetëm personave juridikë dhe fizikë të cilat kanë objekte lundruese të regjistruara (varkë, jaht, anije etj.) dhe për të cilat në rregulloret që rregullojnë sigurinë e lundrimit detar është përcaktuar që duhet të jenë të pajisura me pajisje piroteknike për shpëtimin në det.

Pajisjet piroteknike të kategorisë II mund të jenë në shitje në periudhën nga data 20 dhjetor deri 15 janar dhe mund t’u shiten vetëm personave me moshë mbi 18 vjeç.

Ministria, me qëllim ruajtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, të mjedisit dhe të pronës, mund të urdhërojë shkurtimin e kohës së shitjes së pajisjeve piroteknike të përmendura në paragrafin 3 të këtij ligji, si dhe kufizimin e shitjes dhe përdorimit të pajisjeve piroteknike të caktuara të kategorisë II.

Ministria është e detyruar që urdhrin e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni ta publikojë në mjetet e informimit publik jo më vonë se data 1 nëntor e vitit aktual.

#### **Kufizimet**

##### **Neni 45d**

Përdorimi i pajisjeve piroteknike të kategorisë II është i ndaluar:

- gjatë vitit, nga data 16 janar deri më 19 dhjetor,
- në ambiente të brendshme,
- në ambient ku grumbullohet numër i madh njerëzish.”

#### **Neni 21**

Në nenin 47 paragrafi 2 fjalët “diplomë universitare në një degë të caktuar”, zëvendësohen me fjalët: “të paktën nivelin e pestë të kuadrit të brendshëm të kualifikimit (V)”.

Paragrafi 3 fshihet.

## **Neni 22**

Në nenin 50 paragrafi 3 fjalët “kategoria I, II, III dhe IV “ zëvendësohen me fjalët “kategoria I, II, III, IV, T1 dhe T2”.

## **Neni 23**

Në nenin 51 paragrafi 2 ndryshohet dhe bëhet:

“Leja për hedhjen e fishekzjarrëve publike përcaktohen llojin dhe kategorinë e pajisjeve piroteknike për këtë qëllim, vendin dhe kohën e hedhjes së fishekzjarrëve publike, si dhe personin përgjegjës për hedhjen e tyre”.

Pas paragrafit 2 shtohen dy paragrafë të rinj, të cilët bëhen:

“Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, shoqërohet me:

- planin për hedhjen e fishekzjarrëve publike;
- miratimin e pronarit ose përdoruesit të vendit, respektivisht të objektit në të cilin planifikohet hedhja e fishekzjarrëve publike;
- provë me shkrim me të cilën vërtetohet prania, gjatë hedhjes së fishekzjarrëve publike, e njësisë qeveritare vendore, përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë.

Kushtet e detajuara dhe masat e sigurisë për hedhjen e fishekzjarrëve publike, si dhe përmbajtja e planit për hedhjen e fishekzjarrëve publike, përcaktohen nga ministria.”

## **Neni 24**

Në nenin 54 paragrafi 2 fjalët “diplomë universitare në një degë të caktuar” zëvendësohen me fjalët “të paktën nivelin e pestë të kuadrit të brendshëm të kualifikimit (V), në industrinë e minierave dhe nga fakultete të tjera teknike.”

## **Neni 25**

Në nenin 55 paragrafi 1, pika 1 fjala “biznes” zëvendësohet me fjalën “veprimtari”, ndërsa në nënparagrafin 1 fjalët “Regjistri qendror i gjykatës tregtare” zëvendësohet me fjalët “Regjistri qendror i subjekteve tregtare”.

## **Neni 26**

Në nenin 57 paragrafi 2 fjalët “diplomë universitare” zëvendësohet me fjalët “niveli i shtatë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit, nën niveli një (VII – 1)”.

## **Neni 27**

Në nenin 58 paragrafi 3, nënparagrafi 1, fjalët “diplomë e shkollës së mesme, e kolegjit ose universitare” zëvendësohet me fjalët “të paktën nivelin e katërt të kuadrit të brendshëm të kualifikimit (IV)”.

Në nënparagrafin 3, fjalët “diplomë e shkollës së mesme” zëvendësohet me fjalët “niveli i katërt i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (IV)”, ndërsa fjalët “diplomë kolegj ose universitare” me fjalët “të paktën niveli i pestë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (V)”.

## **Neni 28**

Në nenin 59 paragrafi 3, nënparagrafi 1, fjalët “diplomë kolegj ose universitare” zëvendësohen me fjalët “të paktën niveli i pestë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (V)”.

Në nënparagrafin 3, fjalët “diplomë kolegj” zëvendësohen me fjalët “niveli i pestë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (V)”, ndërsa fjalët “diplomë universitare”, me fjalët “niveli i shtatë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit, nën niveli një (VII-1)”.

## **Neni 29**

Në nenin 61 paragrafi 3, nënparagrafi 1, fjalët “diplomë e shkollës së mesme, e kolegjit ose universitare” zëvendësohen me fjalët “të paktën niveli i katërt i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (IV)”.

Në nënparagrafin 3, fjalët “diplomë e shkollës së mesme” zëvendësohen me fjalët: “niveli i katërt i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (IV)”, ndërsa fjalët “diplomë kolegj ose universitare”, me fjalët “të paktën niveli i pestë i kuadrit të brendshëm të kualifikimit”.

### **Neni 30**

Në nenin 63, paragrafi 1, nënparagrafi 2, fjalët: “diplomë e shkollës së mesme” zëvendësohen me fjalët “niveli i katërt i kuadrit të brendshëm të kualifikimit (IV)”.

### **Neni 31**

Në nenin 75 pas fjalës “distancë” shtohen fjalët “dhe kufiri i zonës së rrezikut”.

### **Neni 32**

Neni 76 ndryshohet dhe bëhet:

“Ministria mban evidencat për:

- Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar, domethënë të emëruar për kryerjen e vlerësimit të përputhshmërisë së lëndëve plasëse;
- lëndët plasëse për të cilat është dhënë leje për hedhje në treg;
- lejet e dhëna për prodhim, hedhje në treg, blerje të lëndëve plasëse, veprimtari me fishekzjarrë publikë, hedhje të fishekzjarrëve publike, veprimtari minerare dhe autorizim për kryerjen e veprimtarive minerare;
- lejet e dhëna për prodhim të lëndëve plasëse në vendin e përdorimit;
- vendimet e dhëna për ndërprerje të vlefshmërisë së lejes për prodhim, shitje të lëndëve plasëse, veprimtarive me fishekzjarrë publikë dhe kryerje të veprimtarive minerare;
- vendimet e dhëna për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për prodhim të lëndëve plasëse në vendin e përdorimit;
- kampionet e marra të lëndëve plasëse;

Shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi që prodhojnë lëndë plasëse administrojnë evidencat mbi llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të prodhuara, të shitura, të përdorura, të asgjësuara, të kthyer, të humbura ose të vjedhura.

Shoqëria tregtare e cila prodhon lëndë plasëse në vendin e përdorimit, administron evidencat mbi llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të prodhuara, të shitura, të përdorura dhe të asgjësuara.

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi të cilët kryejnë shitjen, blerjen dhe/ose përdorimin e lëndëve plasëse, administrojnë evidencat mbi sasinë dhe llojin e lëndës plasëse të blerë, të shitur, të përdorur, të asgjësuar, të kthyer, të humbur ose të vjedhur.

Evidencat e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 i këtij neni ruhen 10 vjet, ndërsa evidencat e përmendura në paragrafin 3 dhe 4 i këtij neni ruhen për pesë vjet.

Përmbajtja dhe mënyra e administrimit të evidencave të përmendura në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni i përcaktohen nga ministria.

### **Neni 33**

Në nenin 79 paragrafi 1 pas nënparagrafit 7, shtohen dy nënparagrafë të rinj, të cilët bëhen:

“-ndalon prodhimin e lëndëve plasëse në vendin e përdorimit për shkak të parregullsive të shkaktuara gjatë ndërmarrjes së masave të veçanta të cilat mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve ose të mjedisit;

- ndalon hedhjen e fishekzjarrëve publike, në qoftë se konfirmohet se në vendin e hedhjes nuk janë plotësuar kushtet për hedhjen e tyre;”

### **Neni 34**

Neni 80 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi juridik ose sipërmarrësi dënohet me gjobë nga 1500 deri 16 000 euro në qoftë se:

- 1) nuk miraton aktin e përgjithshëm të përmendur në nenin 6 paragrafi 2 të këtij ligji;
- 2) Personi i cili administron ose kryen veprimet në lidhje me lëndët plasëse nuk njihet me masat e përcaktuara me aktet nga neni 6 paragrafi 2 i këtij ligji ose ato nuk i përgatit për të proceduar në rastin e fatkeqësive tekniko-teknologjike ose rreziku tjetër, në bazë të dispozitës për ruajtjen dhe shpëtimin (neni 7);
- 3) nuk siguron ruajtje të përhershme fizike dhe teknike të objekteve në të cilët kryhet prodhimi ose magazinimi i lëndëve plasëse (neni 8);
- 4) nuk organizon dhe nuk monitoron zbatimin e masave të parashikuara për mbrojtjen

(neni 9);

5) nuk njofton menjëherë ministrinë dhe autoritetin administrativ kompetent për ushtrim të çështjeve të policisë për humbjen ose vjedhjen e lëndëve plasëse dhe të paktën brenda një ore pas marrjes së informacionit, (neni 10)

6) hedh në treg dhe përdor lëndë plasëse pa leje për hedhje në treg (neni 12 paragrafi 1);

7) kryen veprimtari të përmendura në nenin 13 të këtij ligji pa autorizim (neni 14 paragrafi 1);

8) lejon administrimin e lëndës plasëse nga një person që nuk plotëson kushtet për administrim të lëndëve plasëse (neni 19 paragrafi 1);

9) fillon prodhimin e lëndëve plasëse pa lejen e ministrisë (neni 22 paragrafi 2) ose vazhdon prodhimin edhe nëse nuk përmbush kushtet e përmendura në nenin 23 i këtij ligji;

10) kryen kërkime për lloje të reja lëndësh plasëse pa lejen e ministrisë (neni 28 paragrafi 3);

11) prodhon lëndë plasëse në vendin e përdorimit pa lejen e ministrisë (neni 30a paragrafi 1);

12) nuk e përdor lëndën plasëse të prodhuar në vendin e përdorimit në vend dhe drejtpërdrejt për mbushjen e vrimave të parapërgatitura të minave (neni 30e, paragrafi 1);

13) Paketon dhe magazinon lëndën plasëse të prodhuar në vendin e përdorimit (neni 30a paragrafi 2);

14) Për vendin e përdorimit në të cilin kryhet prodhimi i lëndëve eksplozive nuk siguron ruajtje të përhershme fizike (neni 30g);

15) Hedh në treg lëndë plasëse pa lejen e ministrisë (neni 32 paragrafi 1);

16) shet lëndë plasëse për shoqëri tregtare, persona juridikë, sipërmarrës ose persona fizik, të cilët nuk kanë leje për blerje të lëndëve plasëse (neni 35);

17) blen lëndë plasëse pa lejen e ministrisë (neni 37 paragrafi 1);

18) shet pajisje piroteknike të kategorisë I për persona më të rinj se 16 vjeç ose mban më shumë se 100 kg pajisje piroteknike të kategorisë I në objektin e shitjes të përmendur në nenin 31, paragrafi 1 të këtij ligji (neni 45c paragrafi 1);

19) Shet pajisje piroteknike të kategorisë P1 për persona juridikë ose fizikë të cilët nuk kanë objekte lundruese të regjistruara (varkë, jaht etj.) (neni 45c paragrafi 2);

20) shet pajisje piroteknike në periudhën kur shitja është e ndaluar ose shet pajisje piroteknike të kategorisë II për persona më të rinj se 18 vjeç (neni 45c paragrafi 3);

21) hedh fishekzjarrë publikë pa lejen e ministrisë (neni 46 paragrafi 2);

22) kryen veprimtari minerare pa lejen e ministrisë (neni 53);

23) gjatë veprimtarive minerare, nuk ndërmer masa sigurie për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, të ambientit dhe pronës (neni 57 paragrafi 1);

24) nëpërmjet asgjësimit të parregullt dhe joprofesional të lëndëve plasëse rrezikon jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, të mjedisit dhe pronës (neni 64 paragrafi 1 dhe 2);

25) objektet e prodhimit dhe të magazinimit të lëndëve plasëse nuk i ndërton dhe nuk i pajis në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe të garantojë sigurinë e njerëzve, jetës dhe bimëve, ambientit dhe pronës (neni 65);

26) Objektet e prodhimit dhe të magazinimit të lëndëve plasëse i ndërton pa marrë mendim mbi vendndodhjen dhe pa miratimin e projektit dhe të dokumentacionit tekniko-investues (neni 66);

27) Kontejnerin e vendos në kundërshtim me nenin 67 të këtij ligji;

28) Objektet e prodhimit dhe të magazinimit i përdor pa autorizimin e ministrisë (neni 74).

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 i këtij ligji, personi përgjegjës në personin juridik do të dënohet me gjobë nga 300 euro deri 1500 euro.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 i këtij neni, shoqëria tregtare do të dënohet me gjobë nga 750 euro deri 4000 euro.”

### Neni 35

Neni 81 ndryshon dhe bëhet:

“Personi juridik dënohet për shkelje me gjobë nga 1500 euro deri 10 000 euro, në qoftë se:

1) lëndët plasëse i administron personi pa kualifikimin profesional dhe nuk është nën mbikëqyrjen e personit që është i kualifikuar profesionalisht për administrimin e lëndëve plasëse dhe



në qoftë se nuk është njohur paraprakisht me mënyrën e punës, rreziqet dhe masat e mbrojtjes në vendin e punës (neni 20 paragrafi 1);

2) brenda tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së leje për prodhim të lëndëve plasëse nuk i dërgon ministrisë evidencat e administruara në përputhje me këtë ligji (neni 26 paragrafi 2);

3) brenda tetë ditësh nuk njofton ministrinë për fillimin, ndryshimin ose pushimin e ushtrimit të veprimtarisë (neni 30);

4) brenda tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për heqjen e lejes për shitje të lëndëve plasëse nuk i dërgon ministrisë evidencat e administruara në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 36 paragrafi 2);

5) blen lëndë plasëse të nevojshme për kryerjen e veprimtarive minerare dhe pajisje piroteknike për hedhjen e fishekzjarrëve publike në sasi të cilat nuk mund të magazinohen (neni 40);

6) shet lëndë plasëse, pa mbajtur një kopje të lejes ose nuk përcakton në leje llojin dhe sasinë e lëndës plasëse të shitur (neni 41 paragrafi 2);

7) në kantier, nuk ka kontejner për magazinim të lëndëve plasëse të papërdorura dhe nuk asgjëson lëndët plasëse të papërdorura të asgjësueshme (neni 42 paragrafi 1);

8) magazinon në kontejnerë sasi më të mëdha lënde plasëse dhe mjetesesh ndezëse për qëllime tregtare, se sa është përcaktuar (neni 42 paragrafi 2);

9) depoziton në kontejnerë sasi më të madhe lënde plasëse dhe mjetesesh ndezëse për qëllime tregtare, krahasuar me sasinë e përcaktuar (neni 42 paragrafi 3);

10) Përdor lëndë plasëse në vendndodhje ku autoriteti kompetent ka urdhëruar ndalimin e veprimtarive, kryerja e të cilave kërkon përdorimin e këtyre lëndëve (neni 44 paragrafi 2);

11) brenda tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për pushimin e vlefshmërisë së lejes për hedhjen e fishekzjarrëve publikë, nuk i dërgon ministrisë evidencat e përcaktuara (neni 49 paragrafi 2);

12) hedh fishekzjarrë publikë pa leje ose hedh fishekzjarrë publikë në vendin, kohën, llojin dhe kategorinë e pajisjeve piroteknike në kundërshtim me lejen për hedhje të fishekzjarrëve publik (neni 51);

13) brenda tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për ushtrimin e veprimtarive minerare, nuk i dorëzon ministrisë evidencat e përcaktuara (neni 56 paragrafi 2);

14) nuk ndërmerr masa sigurie, nuk përpunon planin veprimtarisë minerare ose nuk e ushtron atë në përputhje me planin e veprimtarisë minerare (neni 57 paragrafi 1);

15) kryen veprimtari minerare në vende të populluara ose pranë tyre, pa njoftuar më parë ministrinë, organin administrativ kompetent për çështjet e policisë, publikun dhe shoqëritë tregtare dhe persona të tjerë juridikë të cilët administrojnë rrugët, hekurudhat, ujësjellësit, transmetimin e energjisë elektrike ose atë telefonike ose objekte të ngjashme (neni 57 paragrafi 3);

16) veprimtaritë minerare sipërfaqësore, të veçanta, nëntokësore ose çminimi, kryhen nga persona pa leje për ushtrimin e veprimtarive ose për kryerje të llojeve të caktuara të veprimtarive minerare (nenet 58, 59, 60 dhe 61);

17) Veprimet e përgatitjes së veprimtarisë minerare ose të veprimet ndihmëse për përgatitjen e veprimtarisë minerare kryhen nga një person fizik i cili nuk i plotëson kushtet e përmendura në nenin 63 të këtij ligji;

18) në objektin e prodhimit ose të magazinimit të parashikuar për shumë lloje lëndësh plasëse, lëndët nuk magazinohen në dhoma të ndara ose në struktura të ndërtuara posaçërisht për këtë qëllim ose mjettet ndezëse mbahen bashkë me lëndët plasëse (neni 68);

19) nuk administron dhe nuk ruan evidencat e përcaktuara për llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të prodhuara, të shitura, të përdorura, të asgjësuar, të kthyera, të humbura ose të vjedhura (neni 76 pika 2, 3 dhe 4).

Personi përgjegjës në personin juridik, për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë nga 300 euro deri në 1000 euro.

shoqëria tregtare, për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë nga 750 euro deri në 2500 euro.”

Neni 82 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi fizik dënohet me gjobë nga 150 deri 550 euro në qoftë se:

1) pas përmbylljes së punimeve, nuk kthen sasinë e mbetur të lëndëve plasëse te shoqëria tregtare, personi tjetër juridik ose sipërmarrësi tek të cilët i ka blerë ose në qoftë se ato nuk asgjësohen nga personi kompetent dhe për këtë nuk njofton ministrinë dhe autoritetin

kompetent për çështjet e policisë (neni 38 paragrafi 4);

2) përdor pajisje piroteknike të kategorisë II jashtë periudhës së lejuar (neni 45 paragrafi 1 nënparagrafi 1);

3) përdor pajisje piroteknike në periudhën e lejuar në ambiente të mbyllura (neni 45d paragrafi 1 nënparagrafi 2);

4) përdor pajisje piroteknike në ambiente ku grumbullohet një numër i madh njerëzisht (neni 45 paragrafi 1 nënparagrafi 3);

5) kryen veprimtari minerare sipërfaqësore, speciale dhe/ose të nëntokësore dhe/ose çminimi, pa zotëruar lejen për kryerjen e këtyre veprimtarive (neni 58 paragrafi 1, neni 59 paragrafi 1, neni 60 paragrafi 1 dhe neni 61 paragrafi 1);

6) kryen veprime për përgatitjen e veprimtarive minerare pa plotësuar kushtet e përmendura në nenin 63 paragrafi 1 i këtij ligji.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personit fizik dënohet për shkelje me gjobë në shumë prej 200 euro.”

### **Neni 37**

Pas nenit 83, shtohet nen i ri i cili bëhet:

“**Afati kohor për miratimin e akteve nënligjore**

#### **Neni 83a**

Aktet nënligjore të nenit 45b paragrafi 2 dhe të neni 51 paragrafi 4 i këtij ligji miratohen brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”

### **Neni 38**

Pas nenit 87 shtohet nen i ri i cili bëhet:

“**Ndërprerja e vlefshmërisë**

#### **Neni 87a**

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon vlefshmëria e nenit 14 të ligjit për ndryshimet e ligjit me të cilët përcaktohen dënimet me gjobë për shkelje (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 40/11.)”

### **Neni 39**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga data e botimit të tij në “Fletoren Zyrtare të Malit të Zi”.